VENDIM
Nr. 18, datë 19.3.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 13.3.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 24 (Sh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA "Kosturr Kromi" sh.p.k., përfaqësuar nga avokate Antoneta Sevdari, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1529 akti, datë 28.7.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 740, datë 23.8.2022, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2023-413, datë 7.3.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 27, pikat 1 dhe 2, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)* dhe neni 1, i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses, shoqërisë "Kosturr Kromi" sh.p.k., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria "Blerimi Kosturr 2010" sh.p.k., me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin H.Sh., zotëron një "leje minerare", të miratuar me aktin nr. 1721, datë 19.6.2014, për të kryer veprimtari minerare në një zonë të lejuar për nxjerrjen e mineralit të kromit, me vendndodhje në Gzhime, Has, Kukës, me një periudhë vlefshmërie 25 vjet. Në datën 18.4.2017, është bërë regjistrimi i shoqërisë tregtare "Kosturr Kromi" sh.p.k. (*kërkuesja*), ku sipas ekstraktit të kësaj shoqërie administrator është

shtetasi kinez L.J. zotërues i 51% të kuotave, shtetasi H. Sh., administrator i shoqërisë "Blerimi Kosturr 2010", është ortak me 25% të kapitalit, shtetasja M. M., me cilësinë e ortakes, zotëron 18% të aksioneve dhe shtetasi I.S., me cilësinë e ortakut, zotëron 6% të aksioneve.

2. Me aktmarrëveshjen e nënkontraktimit nr. 75 rep., nr. 30 kol., datë 24.4.2017, shoqëria "Blerimi Kosturr 2010" sh.p.k. i ka dhënë me nënkontraktim shoqërisë "Kosturr Kromi" sh.p.k. të drejtën e lejes minerare të shfrytëzimit, e cila është miratuar me shkresën e datës 14.6.2017, të ministrit të Energjisë dhe Industrisë. Kjo aktmarrëveshje është zbatuar përgjatë viteve 2017–2018 dhe kërkuesja ka kryer investime për hapjen e minierës dhe, më pas, ka filluar shfrytëzimin e mineralit të kromit, nxjerrjen dhe shitjen e tij në tregun ndërkombëtar.

3. Në datën 27.10.2020, shtetasi H.Sh. ka paraqitur kallëzim penal ndaj administratorit të shoqërisë "Kosturr Kromi" sh.p.k., shtetasit kinez L. J., duke pretenduar se regjistrimi i shoqërisë së tij "Blerimi Kosturr 2010" sh.p.k., në cilësinë e ortakut dhe zotëruesit të 25% të kapitalit, është bërë përmes mashtrimit nga ai shtetas dhe dy ortakët e tjerë. Kallëzuesi ka pretenduar se asnjëherë nuk është biseduar apo rënë dakord që nga marrëveshja e bashkëpunimit shoqëria "Blerimi Kosturr 2010" sh.p.k. do të përfitonte 25% të kuotave të shoqërisë nënkontraktore "Kostur kromi" sh.p.k., por se do të përfitonte 25% të sasisë së kromit të nxjerrë në sipërfaqe, ndërsa 75% do t'i mbetej shoqërisë nënkontraktore.

4. Mbi bazën e këtij kallëzimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 16.3.2021, ka regjistruar procedimin penal nr. 1868 për veprat penale "Mashtrimi", "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuara nga nenet 143, 186 dhe 248 të Kodit Penal (*KP*). Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore prokurori ka arritur në përfundimin se ekzistojnë dyshime të arsyeshme se shtetasi L. J., në cilësinë e administratorit, ka kryer veprën penale "Mashtrimi" dhe shoqëria që përfaqëson (*kërkuesja*) ka kryer veprime juridike që përbëjnë përgjegjësi penale për këtë subjekt sipas nenit 3, të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007, "Për përgjegjësinë penale të subjekteve juridike". Për këtë arsye në datën 19.5.2021, ai i ka kërkuar gjykatës vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të parashikuar nga neni 274 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), për të gjithë pasurinë krom të pashitur dhe makineritë për nxjerrjen e tij në ngarkim të kërkueses. Gjithashtu, nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues, rezulton se shtetasi L. J. ka qenë në detyrën e administratorit të shoqërisë "Kosturr Kromi" sh.p.k. deri në datën 21.4.2022, kur me vendim të asamblesë së shoqërisë është zëvendësuar me një administrator tjetër.

5. Me vendimin nr. 1241 akti, datë 5.6.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe caktimin e masës së sigurimit të sekuestros preventive për të gjithë pasurinë krom të pashitur dhe makineritë e pajisjet e ndodhura/instaluara për nxjerrjen e kromit, që gjenden në hapësirën brenda koordinatave të lejes minerare dhe për pasurinë krom stok të ndodhur në vendin e grumbullimit të kromit, të cilat janë në ngarkim të shoqërisë "Kosturr Kromi" sh.p.k. Mbi ankimin e kërkueses, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 592, datë 14.7.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive.

6. Në vijim, prokurori i është drejtuar sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për caktimin e masës së sigurimit të sekuestros preventive. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1529 akti, datë 28.7.2022, ka vendosur: "*Pranimin e kërkesës. Caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive", mbi të gjithë pasurinë krom stok (të pashitur) dhe makineri e pajisje të ndodhura/instaluara për nxjerrjen e kromit në hapësirën brenda koordinatave të lejes minerare nr. 1721, datë 19.6.2014, të ndodhur në vendin e quajtur "Gzhime", fshati Helshan të rrethit Has, qarku Kukës. Vendosjen e sekuestros preventive të kromit stok (të pa shitur) në vendin e grumbullimit të kromit në adresën: lagjja nr. 15, rruga "Miqësia", Spitallë të rrethit Durrës, të cilat janë në ngarkim të shoqërisë "Kosturr kromi" sh.p.k., me administrator personin nën hetim L. J.*". Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 740, datë 23.8.2022, ka vendosur të miratojë vendimin nr. 1529 akti, datë 28.7.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-413, datë 7.3.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

9. Pas dhënies së vendimit nr. 740, datë 23.8.2022, të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkuesja i është drejtuar sërish gjykatës me kërkesë për revokimin/heqjen e masës së sekuestros preventive, për arsye se ndalimi i punës në minierë ka shkaktuar pasoja të rënda jo vetëm ekonomike, jo vetëm për shoqërinë, por edhe për sigurinë në minierë. Për këtë qëllim ajo ka paraqitur në gjykatë shkresën nr. 3377 prot., datë 18.8.2022 të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Për këtë shkak, me vendimin nr. 1985, datë 23.12.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës, heqjen e masës së sekuestros preventive të caktuar me vendimin nr. 1529 akti, datë 28.7.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për sa u përket makinerive dhe pajisjeve të ndodhura/instaluara që duhen për: ç'ujëzimin e punimeve nëntokësore; ajrimin e punimeve nëntokësore (përfshirë edhe depon e ruajtjes së lëndëve plasëse që ndodhet nëntokë); mirëmbajtjen e armatimit për punimet kapitale; monitorimin e vazhdueshëm të hapësirave të shfrytëzuara dhe ndikimin e tyre në minierë; mirëmbajtjen e oxhakut, rrugëdalja e dytë nga hz.+425 m deri në sipërfaqe. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 142, datë 27.2.2023.

10. Në përfundim të hetimeve, në lidhje me procedimin penal nr. 1868 të vitit 2021, prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes penale. Në seancën paraprake të datës 9.11.2023, para gjyqtarit të seancës paraprake, kërkuesja ka përsëritur kërkesën për heqjen e sekuestros preventive të vendosur me vendimin nr. 1529 akti, datë 28.7.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. 2681, datë 9.11.2023, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 1868 të vitit 2021 që i përket shtetasit kinez L. J. dhe subjektit tregtar shoqërisë "Kosturr Kromi" sh.p.k., si dhe, ndër të tjera, rrëzimin e kërkesës për revokimin/heqjen e sekuestros preventive.

11. Në datën 14.9.2023, përmes shërbimit postar, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në këtë Gjykatë në datën 18.9.2023. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 19.10.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesja***, shoqëria "Kostur Krom" sh.p.k., në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

12.1 Kërkesa plotëson kriterin paraprak të shterimit të mjeteve juridike efektive. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara mund të bëhen objekt i ankimit kushtetues individual, pasi ato kanë prodhuar pasoja të cilat nuk mund të riparohen nga vendimi përfundimtar i përcaktimit të fajësisë, pasi masa e sekuestros preventive ka sjellë si pasojë shkatërrimin e minierës. Kërkuesja e ka pasur të pamundur të revokojë masën e sigurimit pasuror, megjithëse e ka kundërshtuar disa herë atë në gjykatat e zakonshme. Në vendimin e saj të datës 23.12.2022, gjykata e shkallës së parë ka pranuar pjesërisht kërkesën, duke vendosur heqjen e masës së sekuestros preventive për sa u përket makinerive dhe pajisjeve për të garantuar sigurinë në minierë, por nuk e ka lejuar atë të kryejë aktivitet ekonomik, vendim i cili është lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Ndërsa me vendimin e datës 9.11.2023, gjykata e shkallës së parë, në seancë paraprake, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për heqjen e masës së sekuestros dhe dërgimin në gjykim të çështjes penale në ngarkim të shtetasit L. J. dhe shoqërisë (kërkueses).

12.2 Është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit* të lidhur me *të drejtën e aksesit dhe asaj për t'u dëgjuar*, pasi gjykatat në vendimet objekt kundërshtimi nuk u kanë kthyer përgjigje të argumentuar pretendimeve të paraqitura nga kërkuesja, për më tepër ato as nuk janë pasqyruar në vendimet e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është kontradiktor dhe jologjik, pasi megjithëse ajo është shprehur se akoma nuk është identifikuar dëmi që i është shkaktuar paditësit në gjykim dhe nuk është identifikuar autori i falsifikimit, në përfundim ka vlerësuar se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprës penale. Kjo gjykatë ka paraqitur fakte të pavërteta, të cilat nuk janë të pasqyruara në aktin e ekspertimit kontabël (si p.sh. shitja e kromit pa faturë, fakti se huaja e kthyer u është fshehur deklarimeve dhe detyrimeve tatimore ose përcaktimi i çmimit të kromit). Këto fakte të pavërteta janë pranuar edhe nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs, por është mjaftuar me një arsyetim të shkurtër.

12.3 Është cenuar *e drejta e pronës private*, pasi vendimi i sekuestrimit të pasurisë është vënë menjëherë në zbatim, duke ndaluar punën në minierë. Kjo situatë zgjat prej një viti e katër muajsh dhe kufizimi i së drejtës së gëzimit paqësor të pronës nuk është bërë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Ndalimi i punës në minierë ka sjellë dëme ekonomike, por, gjithashtu, rrezikon jetën e banorëve të zonës nga shpërthimet e mundshme.

12.4 Është cenuar parimi i shtetit të së drejtës të lidhur me atë të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike, si dhe të drejtën për të mos u gjykuar dy herë, parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, ankimit efektiv dhe barazisë para ligjit.

13. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

13.1 Kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, pasi objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të cilat kanë pranuar kërkesën e prokurorit për vendosjen e masës së sekuestros preventive ndaj pasurisë së shoqërisë në kuadër të një procedimi penal. Ky procedim është duke u gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Në kushtet kur procedimi penal në ngarkim të shtetasit L. J. dhe kërkueses ende nuk ka përfunduar, vendimi gjyqësor është jopërfundimtar dhe nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues. Në përfundim të gjykimit gjykatat do të shprehen edhe për shfuqizimin e masës së sekuestros ose konfiskimin e pasurisë në varësi të deklarimit në lidhje me fajësinë.

13.2 Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar, pasi vendimet gjyqësore nuk rezultojnë të jenë alogjike ose të kenë kundërthënie, ndërsa pjesa arsyetuese lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv. Gjithashtu, ato pasqyrojnë në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e ankimit/rekursit dhe vlerësimin e gjykatave. Kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë se si vendimet gjyqësore i kanë cenuar të drejtën për gjykim të drejtë, duke mos e ngritur pretendimin e saj në nivel kushtetues.

13.3 Edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës nuk qëndron, pasi sekuestro preventive është një masë e përkohshme, e marrë në kushtet e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova, në kushtet e urgjencës dhe ka për qëllim parandalimin dhe kryerjen e mëtejshme të veprave penale.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

14. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave

kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae,* si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Në lidhje me kriterin paraprak të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesja ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara mund të bëhen objekt i ankimit kushtetues individual pasi ato kanë prodhuar pasoja të cilat nuk mund të riparohen nga vendimi i themelit të çështjes penale, pasi masa e sekuestros preventive ka sjellë si pasojë shkatërrimin e pronës së saj (minierës) dhe ajo e ka pasur të pamundur të revokojë masën e sigurimit pasuror, megjithëse e ka kundërshtuar disa herë në gjykatat e zakonshme. Sipas kërkueses, edhe pse me vendimin e datës 23.12.2022, gjykata e shkallës së parë ka vendosur heqjen e masës së sekuestros preventive për sa u përket makinerive dhe pajisjeve, me qëllimin për të garantuar sigurinë në minierë, nuk e ka lejuar atë të kryejë aktivitet ekonomik, ndërkohë që edhe me vendimin e datës 9.11.2023, në seancë paraprake, është vendosur rrëzimi i kërkesës për heqjen e masës së sekuestros.

17. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, pasi objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore që kanë vendosur masën e sekuestros preventive ndaj pasurisë së shoqërisë në kuadër të një procedimi penal, ndërkohë që çështja penale është duke u gjykuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në kushtet kur ajo nuk ka përfunduar ende, vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë jopërfundimtare dhe nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Sipas këtij subjekti, në përfundim të gjykimit gjykatat do të shprehen edhe për shfuqizimin e masës së sekuestros ose konfiskimin e pasurisë në varësi të deklarimit në lidhje me fajësinë.

18. Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 75, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata thekson se, në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Për këtë arsye, mjetet juridike në dispozicion nuk përfshijnë vetëm ankimin kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, por çdo ankim ose kundërshtim, duke u ofruar mundësi organeve publike dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të luajnë rolin e tyre subsidiar për t'i garantuar individit mbrojtjen e të drejtave kushtetuese para se ai t'i drejtohet Gjykatës (*shih vendimin nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata vëren se në rastin konkret objekt i kërkesës në shqyrtim janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit me të cilat është vendosur masa e sekuestros preventive për të gjithë pasurinë krom stok dhe makineritë e pajisjet e ndodhura/instaluara për nxjerrjen e kromit. Këto vendime për nga natyra e tyre janë të ndërmjetme për sa kohë që ato merren gjatë procesit penal të gjykimit të fajësisë të të pandehurit me qëllimin për të parandaluar rëndimin ose zgjatjen e pasojës së veprës penale. Për sa i takon kontrollit kushtetues të vendimeve të ndërmjetme, Gjykata ka zhvilluar ndër vite

qëndrimin e saj, duke përfshirë në juridiksionin kushtetues, në mënyrë përjashtimore, edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme në rast se, në kuptim të standardeve të zhvilluara për sa i përket konceptit të vendimit përfundimtar sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, plotësohen këto kritere: i. vendimi duhet të ketë vendosur mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, pra shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar ose, e thënë ndryshe, kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese; ii. vendimi të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; iii. vendimi duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimin nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Bazuar në këtë qasje Gjykata ka marrë në shqyrtim në seancë dy vendime për caktimin e masës së sekuestros, njëra konservative dhe tjetra preventive, të cilat i ka konsideruar si jopërfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Më konkretisht, në vendimin në të cilin kundërshtohej caktimi i sekuestros konservative në kuadër të lejimit të ekzekutimit të një letërporosie të dërguar nga autoritetet e huaja të ndjekjes penale, bazuar në nenin 270 të KPP-së, Gjykata ka vlerësuar se kjo masë sigurimi pasuror është në funksion të procesit penal që zhvillohet ndaj të pandehurit dhe vendosja e saj mund të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar të këtij procesi (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin tjetër që ka të bëjë me sekuestron preventive, të vendosur në kuadër të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar (*ligji nr. 10192/2009*), Gjykata, po kështu, ka vlerësuar se ky vendim nuk ka natyrë përfundimtare dhe nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi i konfiskimit të pasurisë, pasi vendimi përfundimtar i konfiskimit ka aftësinë të ndryshojë dhe riparojë efektet që sjell sekuestrimi (*shih vendimin nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata, duke mos dashur të vërë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të këtyre lloj vendimesh, të cilat jepen gjatë një procesi gjyqësor të themelit dhe në funksion të tij, vlerëson të rëndësishme të rishikojë qasjen e saj ndaj tyre, duke pasur parasysh, *së pari,* ndryshimet kushtetuese që përfshinë në juridiksionin kushtetues edhe ankimin individual për kundërshtimin e çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat substanciale të individit dhe jo vetëm të drejtën për proces të rregullt dhe, *së dyti,* detyrimin që buron nga Kushtetuta, në kuptim të nenit 17 të saj, për garantimin e standardit minimal të mbrojtjes së të drejtave substanciale të ofruar nga KEDNJ-ja dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*). Gjykata, në interpretim të neneve 5, 116, 122 dhe 17/2 të Kushtetutës, duke vënë theksin në statusin e veçantë që ka KEDNJ-ja në rendin e brendshëm ligjor, ka njohur kompetencën ekskluzive të GJEDNJ-së në sistemin tonë juridik dhe efektin e drejtpërdrejtë të vendimeve të saj në interpretimin e standardeve kushtetuese të të drejtave të njeriut (*shih vendimet nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 18, datë 6.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Katalogu i të drejtave të parashikuara në KEDNJ ka statusin e standardit minimal për sa u takon kufizimeve të të drejtave dhe lirive të shprehura në Kushtetutë. Për këtë arsye, Gjykata ka pranuar efektin e drejtpërdrejtë të vendimeve të GJEDNJ-së në interpretimin e standardeve kushtetuese për të drejtat e njeriut, duke iu referuar në mënyrë të vazhdueshme atyre në jurisprudencën e saj.

23. Për qëllime të çështjes konkrete, pra për të arritur në përfundimin nëse të tilla vendime, pavarësisht karakterit të tyre, janë, së pari, të afta të prekin të drejta themelore të individit dhe, së dyti, cenimi është në atë masë dhe formë që pasojat e ardhura është e vështirë ose e pamundur të riparohen gjatë procesit të themelit, Gjykata vlerëson të sjellë në vëmendje qëndrimin e GJEDNJ-së, e cila për përkufizimin e sekuestrimit u është referuar përcaktimeve të Konventës së Këshillit të Evropës "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit", të datës 16.5.2005, sipas së cilës ai (sekuestrimi) konsiderohet një masë e përkohshme dhe që zakonisht

i paraprin konfiskimit. Kështu, GJEDNJ-ja është shprehur se fakti që kërkuesja kishte kërkuar heqjen e masës së sekuestrimit të vendosur nga prokurori, është i mjaftueshëm për GJEDNJ-në për të konstatuar përmbushjen e kriterit të shterimit të mjeteve juridike (*shih Căpăţînă kundër Rumanisë, datë 28.2.2023, § 32).*

24. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka marrë në shqyrtim vendimet e caktimit të masës së sekuestros pavarësisht se procesi i gjykimit të çështjes në themel ende nuk kishte përfunduar, duke i trajtuar ato në këndvështrim të së drejtës së pronës (*shih Łysak kundër Polonisë, datë 7.10.2021, § 65).* Edhe kur ekzistojnë disa mjete juridike në sistemin kombëtar, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se fakti që kërkuesi kishte paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe ankim kushtetues, si dhe kishte kërkuar disa herë gjatë procesit heqjen e masës së sekuestros, është i mjaftueshëm për të përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike (*shih Džinić kundër Kroacisë, datë 17.5.2016, § 48).* Në një rast tjetër, GJEDNJ-ja ka konstatuar se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike në dispozicion, pasi nuk kishte paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për të kundërshtuar vendimin e sekuestros së dokumenteve dhe parave të shoqërisë së tij, në ndryshim nga vendimi për sekuestron e llogarive bankare, të cilin e kishte kundërshtuar deri në Gjykatën Kushtetuese (*shih Benet Praha, Spol. S R.O. kundër Republikës së Çekisë, datë 24.2.2011, §§ 77, 81).*

25. Gjykata çmon të theksojë se të dyja rastet e referuara më sipër, në të cilat ajo ka shqyrtuar kërkesa që lidhen me vendimet që kanë caktuar masa të sekuestros (preventive ose konservative), ajo i ka trajtuar kryesisht në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Ndërkohë që pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016 që zgjeruan juridiksionin e saj, e lidhur kjo edhe me detyrimin e nenit 17 të Kushtetutës, Gjykata u referohet praktikës dhe standardeve të vendosura nga GJEDNJ-ja për garantimin e të drejtave substanciale, standarde që konsiderohen si mbrojtje minimale e tyre. Thënë kjo, Gjykata vlerëson se përjashtimi i vendimeve të caktimit të masës së sekuestros nga kontrolli kushtetues do të binte ndesh me qëndrimin dhe praktikën e GJEDNJ-së, për rrjedhojë do të sillte mohim të mbrojtjes së të drejtave substanciale të individit. Gjithashtu, Gjykata thekson se në të tilla raste ajo mund të ndalet rast pas rasti edhe në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ky proces mund të ndikojë të drejtën substanciale në vetvete.

26. Bazuar në sa më sipër, duke synuar që ankimi kushtetues individual të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen sa më të përshtatshme të të drejtave dhe lirive themelore të individit, Gjykata vlerëson se ka vend për zhvillimin e qasjes së saj edhe në drejtim të vlerësimit të natyrës së vendimeve të ndërmjetme për caktimin e sekuestros. Në këtë këndvështrim, ky zhvillim nuk bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit, por në zbatim të detyrimeve që burojnë nga standardet e GJEDNJ-së, pasi e kundërta do të konsiderohej shkelje prej vetë asaj (*shih vendimet nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 30, datë 17.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe GJEDNJ-ja në praktikën e saj ka theksuar se KEDNJ-ja duhet të interpretohet në dritën e kushteve të ditëve të sotme dhe në përputhje me zhvillimet në të drejtën ndërkombëtare për të reflektuar standardet e larta në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (*shih Demir dhe Baykara kundër Turqisë [DhM], datë 12.11.2008, § 146*).

27. Në rastin konkret, duke shqyrtuar çështjen nën këndvështrimin e së drejtës substanciale të pronës, Gjykata vlerëson se vendimi i caktimit të sekuestros, ndonëse me karakter të përkohshëm dhe që nuk vendos për themelin e çështjes, ndërhyn në të drejtat kushtetuese individuale, siç është ajo e pronës dhe kjo ndërhyrje vazhdon deri në dhënien e një vendimi të mundshëm për konfiskimin e pasurisë. Gjithashtu, ky vendim ka një masë të caktuar autonomie dhe ndonëse i shërben procesit penal, qëndron i pavarur prej tij, në kuptim të efekteve që sjell për shkak të ekzekutimit të menjëhershëm, duke kufizuar të drejtën e pronës, pavarësisht faktit nëse masa e konfiskimit do të legjitimohet ose jo në përfundim të procesit penal. Në këtë kuptim, Gjykata mban parasysh edhe faktin se periudha kohore nga vendosja e saj deri në marrjen e vendimit përfundimtar është relativisht e konsiderueshme, duke mbajtur në konsideratë se vetëm faza e hetimit të çështjes sipas parashikimeve

të KPP-së mund të shkojë deri në dy vjet, shtuar edhe kohën e duhur për përfundimin e procesit gjyqësor në themel, e cila së bashku me ankimet në gjykatat më të larta mund të shkojë deri në katër vjet sipas parashikimeve të KPC-së.

28. Në konkluzion të analizës së saj, Gjykata çmon ta konsiderojë vendimin e caktimit të masës së sekuestros me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues, për sa kohë pretendimet ndaj tij kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave substanciale kushtetuese. Në këtë kuptim, në rastin konkret, kërkuesja i ka shteruar pretendimet e saj në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme, si dhe ka kundërshtuar dy herë të tjera heqjen e masës së sekuestros, kërkesa të cilat nuk kanë qenë të favorshme për të deri në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, ajo e ka përmbushur edhe këtë kriter legjitimimi për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

29. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar nga kërkuesja mban datën 7.3.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë, fillimisht, në datën 14.9.2023. Sipas akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë i është komunikuar përfaqësueses së kërkueses nëpërmjet postës elektronike në datën 15.5.2023, për rrjedhojë Gjykata konstaton se ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor.

30. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të shtetit të së drejtës të lidhur me atë të ligjshmërisë dhe sigurisë juridike, si dhe të së drejtës për të mos u gjykuar dy herë dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, ankimit efektiv dhe barazisë para ligjit. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata konstaton se kërkuesja nuk ka paraqitur asnjë argument kushtetues për të vërtetuar se në ç' mënyrë i janë cenuar këto parime dhe të drejta, për rrjedhojë ato nuk mund të merren në shqyrtim prej saj.

31. Gjithashtu, kërkuesja ka pretenduar edhe se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit dhe asaj për t'u dëgjuar, si dhe të drejtën e pronës. Bazuar në analizën e mësipërme, Gjykata do të marrë në shqyrtim këto pretendime vetëm në drejtim të cenimit të së drejtës së pronës, të parashikuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së pronës

32. Kërkuesja ka pretenduar se vendimi i caktimit të masës së sekuestros së pasurisë është vënë menjëherë në zbatim, duke ndaluar punën në minierë, situatë e cila zgjat prej një viti e katër muajsh dhe kufizimi i së drejtës së gëzimit paqësor të pronës nuk është bërë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Sipas kërkueses, ndalimi i punës në minierë ka sjellë dëme ekonomike, por rrezikon edhe jetën e banorëve të zonës nga shpërthimet e mundshme. Gjithashtu, ajo ka pretenduar se gjykatat në vendimet objekt kundërshtimi nuk i kanë kthyer përgjigje të argumentuar pretendimeve të paraqitura, për më tepër ato as nuk janë pasqyruar në vendimet e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë.

33. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi sekuestro preventive është një masë e përkohshme e marrë në kushtet e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova, në kushtet e urgjencës dhe ka për qëllim parandalimin dhe kryerjen e mëtejshme të veprave penale.

34. Gjykata ka theksuar se garantimi i së drejtës së pronës përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. E drejta e pronës private është e garantuar si një e drejtë universale e njeriut, e cila përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin (*shih vendimet nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.4.2017; nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund

t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kritereve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 15, datë 22.6.2022; nr. 25, datë 28.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe sipas nenit 41 të Kushtetutës e drejta e pronës mund të kufizohet, duke parashikuar si kriter garantues të këtij kufizimi interesin publik.

35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1529 akti, datë 28.7.2022, ka vendosur caktimin e masës së sekuestros preventive, duke u bazuar në këto argumente: administratori i shoqërisë (shtetasi kinez L. J.), në mashtrim të ligjit, i është fshehur detyrimit që kishte si ortak që të paguante 15% të të ardhurave nga shitja e kuotave të tij një shoqërie kineze; transferta bankare e administratorit ndaj një ortaku të shoqërisë është bërë pa e kapitalizuar në bilancin e shoqërisë si shumë të marrë dhe të kthyer; shoqëria ka kryer një sërë punimesh të paspecifikuara dhe është lëshuar një faturë për një person i cili nuk rezulton i punësuar; janë realizuar pagesa të cilat nuk pasqyrohen si detyrim për përmbushjen e disa kontratave shërbimi, por si detyrim nga faturat e shërbimit të projektimit të kryer nga një shoqëri tjetër, gjë që krijon mundësinë që dy shoqëritë të përfitojnë nga rimbursimi i TVSH-së; administratori ka kredituar shoqërinë duke mos pasur një vendim të asamblesë së ortakëve; sasia e kromit të shitur është deklaruar si krom i varfër; huaja e paguar ortakut, shoqërisë kineze, i është fshehur deklarimit dhe detyrimit tatimor; kësaj shoqërie, gjithashtu, i është transferuar e gjithë sasia e kromit pa faturë shitjeje; ortakët nuk kanë marrë asnjëherë dividentë; origjina e parave të investuara në minierë nuk provohet. Gjithashtu, kjo gjykatë është shprehur se nuk është identifikuar dëmi që realisht u është shkaktuar ortakëve dhe buxhetit të shtetit. Për të gjitha këto arsye, gjykata ka krijuar dyshimin e arsyeshëm se shtetasi L. J. ka kryer veprën penale "Mashtrimi" dhe shoqëria (kërkuesja) ka përgjegjësi penale si person juridik, duke vendosur masën e sekuestros preventive për makineritë e nxjerrjes së kromit dhe kromin i cili dyshohet të jetë produkt i asaj vepre penale.

36. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 740, datë 23.8.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se veprimet e administratorit dyshohet të jenë kryer me qëllim që të mos ndajë fitimin për ortakët e shoqërisë dhe për realizimin e përfitimeve të padrejta dhe shmangien e detyrimeve. Gjykata e apelit, gjithashtu, ka evidentuar se nga ana e shoqërisë janë kryer falsifikime të dokumenteve të institucioneve shtetërore. Në mbështetje të argumentit për vendosjen e sekuestros preventive, gjykata e apelit ka arsyetuar se sendet objekt sekuestrimi preventiv mund të bëhen shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale, nëse nuk vendoset sekuestro preventive. Në këtë rast produktet e veprës penale janë të tilla që mbartin lidhjen e drejtpërdrejtë dhe rrezikshmërinë e rëndimit të pasojave të veprës penale. Gjithashtu, ajo ka theksuar se vendosja e masës nuk pengon kryerjen e veprimeve për mirëmbajtjen e sendeve dhe objekteve, si dhe veprimeve të tjera të nevojshme për shmangien e disa prej pasojave të evidentuara; masa e sigurimit pasuror kufizon vetëm tjetërsimin dhe disponimin e lirë të sendeve; kjo është masë e përkohshme dhe organit të akuzës i lind detyrimi që brenda një afati sa më të shpejtë të përfundojë hetimet, me qëllim zbardhjen e të vërtetës, në mënyrë që kjo masë të mos kthehet në një masë joproporcionale.

37. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-413, datë 7.3.2023, nuk ka pranuar rekursin e kërkueses, duke arsyetuar se gjykata e apelit ka dhënë mjaftueshëm argumente në mbështetje të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm për kryerjen nga shtetasi L.J., si administrator i shoqërisë, dhe i kësaj të fundit të veprës penale "Mashtrimi" në dëm të ortakëve të tjerë. Në vijim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar në lidhje me kushtin tjetër të kërkuar për vendosjen e sekuestrimit, rrezikun për dëm nga vonesa, duke vlerësuar të bazuar konkluzionin e gjykatës së apelit që ka të bëjë me ekzistencën e rrezikut që vjen nga disponimi i lirë i mineralit krom dhe makinerive e pajisjeve, duke qenë se vepra penale dyshohet se kryhet pikërisht nëpërmjet shitjes nën kosto të kësaj pasurie, për rrjedhojë disponimi i lirë i tyre mund të ndikojë në rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale ose në lehtësimin e kryerjes së veprave penale të tjera (*shih paragrafët 68 deri 70, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatës së apelit është e arsyetuar si në aspektin formal, ashtu edhe substancial.

38. Gjykata vëren se sipas GJEDNJ-së neni 1, i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së përfshin tri garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e së drejtës së pronës: *garancia e parë* lidhet me parimin e gëzimit të qetë të pronës; *garancia e dytë* lidhet me kufizimet e lejueshme mbi të drejtën e pronës; *garancia e tretë* lidhet me faktin se kufizimi bëhet vetëm për interesin e përgjithshëm, duke u lejuar shteteve të drejtën për të kontrolluar përdorimin e pronës (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin kur ka marrë në shqyrtim masën e sekuestros, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se sekuestrimi i pasurisë në kuadër të procedurave ligjore zakonisht lidhet me kontrollin e përdorimit të pronës sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës dhe jo me privimin e saj (*shih Stołkowski kundër Polonisë, datë 21.12.2021, § 53*).

39. GJEDNJ-ja ka përcaktuar, gjithashtu, se kontrolli i përdorimit të pasurisë nga autoritetet publike duhet të jetë i ligjshëm dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm. Po kështu, ndërhyrja duhet të vendosë një "ekuilibër të drejtë" midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit. Midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti. Sipas kësaj gjykate, për të përcaktuar këtë kriter shtetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi për sa i përket zgjedhjes së mjeteve dhe ajo respekton vlerësimin e shteteve për të përcaktuar çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm ose nuk ka baza të arsyetuara. Ndërsa GJEDNJ-ja pranon dyshimin e arsyeshëm në fillim të hetimeve penale si bazë për ndërhyrje në të drejtën e pronës, hetimet duhet të jenë të shpejta në mënyrë që ndërhyrja të zgjasë për një kohë të kufizuar (*shih Benet Czech, Spol. S.R.O. kundër Republikës Çeke, datë 21.10.2010, § 33, 35–36, 39, 42).* Gjithashtu, ajo ka theksuar se masat e përkohshme të vendosura në kuadër të procedurave gjyqësore, të cilat i paraprijnë një konfiskimi të mundshëm, mund të shkaktojnë dëmtim të pronës, por në mënyrë që dëmi të jetë në përputhje me kriteret e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (shih *Stołkowski kundër Polonisë, datë 21.12.2021, § 56*).

40. Në të njëjtën linjë me sa më sipër, Gjykata, edhe gjatë kontrollit abstrakt të parashikimeve të ligjit nr. 10192/2009, është shprehur se masa e sekuestros ka si tipare të saj urgjencën e ndërhyrjes, si dhe përkohshmërinë e zbatimit të masës (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

41. Në këndvështrim të standardeve të sipërpërmendura, Gjykata vëren se në rastin konkret vendimet të cilat kanë pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sekuestros preventive kanë vendosur jo vetëm kufizimin e disponimit të lirë, pra të shitjes së sasisë së kromit dhe makinerive/pajisjeve të minierës, por edhe të përdorimit dhe posedimit të këtyre të fundit, çka nënkupton se kërkueses i është kufizuar e drejta e pronës në të gjitha tagrat e saj, pasi ajo nuk mund të vijojë aktivitetin e saj prodhues dhe tregtar, pra të gjithë veprimtarinë ekonomike. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar, bazuar në provat e shqyrtuara brenda kompetencës së tyre, se ekziston rreziku, bazuar në dyshime të arsyeshme, që veprimtaria kriminale e mashtrimit të vazhdojë, duke sjellë dëm ndaj buxhetit të shtetit dhe ortakëve të shoqërisë. Në këto kushte, për të vlerësuar nëse ky kufizim respekton kriteret kushtetuese dhe konventore të ndërhyrjes, Gjykata do të vlerësojë nëse ajo është bërë vetëm me ligj, për interes publik dhe nëse respekton kriterin e proporcionalitetit.

42. Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesja është nxjerrë bazuar në nenin 274 të KPP-së, i cili lejon që gjatë një procedimi penal të caktohet sekuestro preventive për sendet që lidhen me veprën penale kur disponimi i lirë i tyre rrezikon të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Në këtë mënyrë, Gjykata vëren se ndërhyrja në të drejtën e pronës është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata sjell në vëmendje se rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal, në kuptimin e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike nga veprimtaria kriminale, ndaj interesi publik është i prezumuar.

43. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata çmon të marrë në analizë disa elemente që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e pasojave që prodhon vendimi për vendosjen e masës së

sekuestros, duke u ndalur për këtë qëllim në vlerësimin e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sekuestros.

44. Lidhur me nevojën, Gjykata do të analizojë nëse masa e marrë është e aftë të realizojë pasojën që ajo synon, pra, në rastin konkret, të sigurojë mbarëvajtjen e procedimit penal në kuadër të të cilit është marrë. Gjykata vëren se vepra penale e mashtrimit e parashikuar nga neni 143 i KP-së e përkufizon atë si marrja ose hedhja në dorë me anë të gënjeshtrës ose të shpërdorimit të besimit të pasurisë të kryera me qëllim të përfitimit material për vete apo për të tjerë. Në rastin konkret, për shkak të natyrës së kësaj vepre penale, konsiderohet se masa e sekuestros ndaj sasisë së kromit të pashitur dhe makinerive/pajisjeve të shoqërisë kërkuese është e nevojshme, pasi është e aftë të sigurojë ndalimin e shitjes së kromit dhe transferimin e përfitimeve te persona të tretë, deri në përfundimin e procesit penal.

45. Lidhur me përshtatshmërinë, në vlerësimin e Gjykatës masa e sekuestros duhet të jetë e arsyeshme, duke balancuar qëllimin e procedimit penal me interesat e individit të përfshirë, në kuptimin që ajo nuk duhet të caktohet përtej asaj që është e pashmangshme. Në rastin konkret, edhe pse masa e sekuestros kufizon të drejtën e pronës, ajo është e përshtatshme dhe jo përtej asaj që është e pashmangshme në këndvështrim të qëllimit të procedimit penal në ngarkim të kërkueses, duke pasur parasysh veprën penale për të cilën akuzohet, për rrjedhojë konsiderohet se është e arsyeshme.

46. Lidhur me ashpërsinë e masës së sekuestros, Gjykata vlerëson se ajo duhet të analizohet në raport me të tre tagrat e së drejtës së pronës, përkatësisht: posedimin, gëzimin (ku përfshihet edhe gëzimi i fryteve të pronës ose zhvillimi i saj) dhe disponimin. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se në çdo rast vendimet për caktimin e masës së sekuestros duhet të përcaktojnë se cilin tagër të së drejtës së pronësisë do të prekin përtej disponimit të lirë të sendit, rreziku për ndodhinë e të cilit duket të jetë synimi kryesor dhe i shprehur i nenit 274 të KPP-së. Në rastin konkret, për sa i takon ashpërsisë, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

47. Kështu, sipas njërit qëndrim u vlerësua se masa e sekuestros preventive tejkalon kriterin e ashpërsisë, pasi duke u vendosur mbi të gjithë sasinë e kromit dhe makineritë e pajisjet në pronësi të kërkueses përbën në thelb ndalim tërësor të veprimtarisë ekonomike të saj, duke passjellë kufizimin e të gjitha tagrave të pronësisë. Edhe pse neni 274 i KPP-së e lidh vendosjen e masës së sekuestros vetëm me disponimin e lirë të sendit, në rastin konkret kjo masë rezulton të ketë kufizuar *de facto* të gjitha tagrat e pronësisë për sa kohë që përmes saj është ndaluar ushtrimi tërësor i veprimtarisë së kërkueses. Nga ana tjetër, edhe pse gjykatat kanë vendosur heqjen pjesërisht të masës së sekuestros, me qëllim mirëmbajtjen e minierës, kjo masë duket se nuk ka sjellë asnjë pasojë konkrete për sa kohë që mungesa e veprimtarisë ekonomike bën të vështirë, deri të pamundur mirëmbajtjen e saj. Për më tepër, nga arsyetimi i gjykatave nuk rezulton se si masa në vetvete i ka shërbyer ose do i shërbente qëllimit për të cilin është caktuar, edhe pas ndryshimit të pjesshëm të saj, dhe, po kështu, nuk është arsyetuar përse në raport me interesat/ të drejtat që janë në lojë duhet të mbizotërojë interesi për mbarëvajtjen e procesit penal. Nën dritën e këtyre argumenteve, kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhej pranuar.[1]

48. Sipas qëndrimit tjetër u vlerësua se edhe pse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë arsyetuar në lidhje me proporcionalitetin e masës së sekuestros së vendosur ndaj kërkueses, e cila ka barrën e provës të provojë pse masa e vendosur është e ashpër, kjo e fundit, në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe të argumenteve të paraqitura nga kërkuesja, duket se nuk e tejkalon kriterin e ashpërsisë në lidhje me natyrën e veprës penale, në kushtet kur masa e sekuestros është hequr pjesërisht me vendim gjyqësor dhe kërkuesja ka mundësinë e mirëmbajtjes së minierës. Gjithashtu, në rast se kjo

[1] Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimi.

masë nuk do të ishte vendosur atëherë nuk do të arriheshin të mbroheshin të drejtat e ortakëve të kësaj shoqërie ose edhe interesat shtetërorë që lidhen me buxhetin e shtetit.[2]

49. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkueses konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.3.2024.
Shpallur më 22.4.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Marjana Semini, Elsa Toska
Anëtarë kundër: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 24 (Sh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkueses shoqëria "Kosturr Kromi" sh.p.k. me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 1529 akti, datë 28.7.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 740, datë 23.8.2022, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2023-413, datë 7.3.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.*", ndajmë të njëjtin qëndrim për rrëzimin e kërkesës, por mbi argumentin se kërkuesja nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të Gjykatës, sepse vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare dhe nuk mund t'i nënshtrohen gjykimit kushtetues. Për këtë shkak çmojmë të shprehemi me mendim paralel.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se në datën 16.3.2021, prokuroria ka regjistruar procedimin penal për kryerjen e disa veprave penale ndaj shtetasit kinez L. J., në cilësinë e administratorit të shoqërisë "Kosturr Kromi" sh.p.k. (*kërkuesja*), e cila ka për objekt të veprimtarisë nxjerrjen dhe shfrytëzimin e mineralit të kromit. Pasi ka arritur në përfundimin se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprave penale, prokuroria i ka kërkuar gjykatës caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive për të gjithë pasurinë krom të pashitur dhe makineritë për nxjerrjen e tij në ngarkim të kërkueses, e cila ka përgjegjësi penale si subjekt juridik. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe caktimin e masës së sigurimit të sekuestros preventive, vendim i cili është lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueses. Në këto kushte, kjo e fundit i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual me pretendimin se vendimet e kundërshtuara kanë prodhuar pasoja të cilat nuk mund të riparohen me vendimin përfundimtar të përcaktimit të fajësisë, si dhe kanë

[2] Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtaret Holta Zaçaj dhe Fiona Papajorgji.

cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit dhe asaj për t'u dëgjuar, si edhe të drejtën e pronës.

3. Referuar nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

4. Gjykata e ka elaboruar në jurisprudencën e saj këtë parashikim, duke theksuar se në kuptim të këtij neni, mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në lidhje me vendimet gjyqësore të ndërmjetme, në raste përjashtimore, Gjykata i ka përfshirë në juridiksionin kushtetues nëse plotësohen njëherazi tre kushte: i. kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; ii. vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; iii. vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimin nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

6. Për sa i përket natyrës së vendimeve të caktimit të sekuestros, Gjykata, për herë të parë, gjatë kontrollit abstrakt të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" (*ligji 10192/2009*), ka bërë dallimin midis konfiskimit dhe sekuestrimit, duke përcaktuar se ky i fundit ka si tipare të tij urgjencën e ndërhyrjes dhe përkohshmërinë e zbatimit të masës, pra heqjen e së drejtës së administrimit të pronës për një periudhë të caktuar kohore. Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata ka theksuar se sekuestrimi është qartazi një masë që ka për qëllim të sigurojë që pasuria, e cila duket se është fryt i veprimtarive të paligjshme të kryera në dëm të bashkësisë, të mund të konfiskohet më tej, nëse është e nevojshme; masa si e tillë është e justifikueshme nga interesi i përgjithshëm dhe nuk mund të thuhet se marrja e saj në këtë fazë të procedimit është disproporcionale me qëllimin që synohet të arrihet (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

7. Në vijimësi, Gjykata e ka konsideruar vendimin e caktimit të sekuestros konservative, të caktuar në bazë të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), si jopërfundimtar për qëllimet e nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi efektet e kësaj mase pushojnë kur vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe në vendime të tjera, Mbledhja e Gjyqtarëve dhe Gjykata janë shprehur se vendimet që jepen për sekuestrimin e pasurive janë vendime të ndërmjetme, në ndryshim nga ato për konfiskimin e pasurisë (*shih vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 135, datë 2.12.2021 dhe vendimin nr. 83, datë 26.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Këtë qëndrim Gjykata e ka përforcuar më tej gjatë shqyrtimit të ankimeve kushtetuese individuale, me objekt kundërshtimi vendimet gjyqësore për caktimin e masës së sekuestrimit bazuar në ligjin nr. 10192/2009, në të cilat ajo ka vlerësuar se këto vendime të ndërmjetme janë të përkohshme, nuk cenojnë thelbin e së drejtës së pronës dhe nuk kanë natyrë përfundimtare, pasi në çdo kohë kërkuesi mund t'i drejtohet gjykatës së juridiksionit të zakonshëm për revokimin e masës. Gjithashtu, vendimmarrja për sekuestrimin nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi i konfiskimit të pasurisë, vendimi i të cilit ka aftësinë të ndryshojë dhe të riparojë në masën e duhur

efektet që sekuestrimi ka sjellë (*shih vendimin nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr. 26, datë 6.2.2023, të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Duke iu kthyer rastit konkret, shumica, pasi ka pranuar karakterin e ndërmjetëm të këtyre vendimeve, ka vlerësuar të rishikojë qasjen e saj ndaj tyre, duke pasur parasysh zgjerimin e juridiksionit kushtetues pas reformës së vitit 2016 dhe detyrimin që buron nga neni 17 i Kushtetutës për garantimin e standardit minimal të mbrojtjes së të drejtave substanciale. Për të arritur në përfundimin nëse këto vendime prekin të drejta themelore të individit dhe se cenimi është në atë masë dhe formë që pasojat e ardhura është e vështirë ose e pamundur të riparohen gjatë procesit të themelit, shumica i është referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, e cila ka marrë në shqyrtim masat e sekuestros së pasurisë. Në analizë të kësaj vendimmarrjeje dhe faktit se më parë ajo i ka shqyrtuar masat e sekuestros në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, shumica ka vlerësuar se përjashtimi i këtyre vendimeve nga kontrolli kushtetues do të binte ndesh me qëndrimin dhe praktikën e GJEDNJ-së, për rrjedhojë do të sillte mohim të mbrojtjes së të drejtave substanciale të individit. Gjithashtu, duke synuar që ankimi kushtetues individual të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen sa më të përshtatshme të të drejtave dhe lirive themelore të individit, shumica ka vlerësuar se ka vend për zhvillimin e qasjes së saj edhe në drejtim të vlerësimit të natyrës së vendimeve të ndërmjetme për caktimin e sekuestros, duke i konsideruar përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe kërkuesja ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për t'iu drejtuar Gjykatës (*shih paragrafët 23–28 të vendimit*).

10. Përkundër vlerësimit të shumicës, ne mendojmë se ky ndryshim në qëndrimin e Gjykatës jo vetëm nuk është në harmoni me parashikimet kushtetuese dhe juridiksionin e Gjykatës, por mund të krijojë një mjet joefektiv për të ardhmen.

11. Në lidhje me parimin e shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se ky parim nënkupton, midis të tjerave, edhe rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës, duke theksuar, nga ana tjetër, se është e pranueshme, në mënyrë të natyrshme, që jurisprudenca kushtetuese të evoluojë me qëllim rritjen e standardeve kushtetuese. Nga kjo pikëpamje ekziston përherë mundësia që jurisprudenca, duke u plotësuar përmes konkluzionesh të reja interpretuese, edhe të ndryshohet, por një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërish e bazuar dhe e arsyetuar. Çdo ndryshim i precedentëve të Gjykatës ose korrigjimi i doktrinës zyrtare kushtetuese mund të bëhet vetëm për arsye të rëndësishme, sidomos për ta harmonizuar atë me praktikën e GJEDNJ-së (*shih vendimet nr. 20, datë 1.6.2011; nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në këtë kontekst jurisprudencial mendojmë se për sa i përket natyrës së vendimeve gjyqësore të sekuestrimit nuk evidentohet ndonjë arsye e rëndësishme për ndryshimin e qëndrimit të Gjykatës për sa kohë dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, mbi të cilën shumica është mbështetur, i përket vitit 2010, përveçse ajo ka qenë e aksesueshme dhe e njohur për Gjykatën e cila, gjithsesi, në ushtrim të kompetencave që i jep Kushtetuta, ka vlerësuar se këto lloj vendimesh nuk mund të përfshiheshin në juridiksionin e saj nisur nga natyra e tyre jopërfundimtare. Ndaj në këtë drejtim nuk pajtohemi me qëndrimin e shumicës se nga Gjykata "*ky zhvillim (i jurisprudencës) nuk bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit, por në zbatim të detyrimeve që burojnë nga standardet e GJEDNJ-së, pasi e kundërta do të konsiderohej shkelje prej vetë asaj*" (*shih paragrafin 26 të vendimit*).

13. Megjithëse evidentohen raste kur GJEDNJ-ja i konsideron këto vendime *ratione materiae*, nga një analizë e përgjithshme, konstatohet se gjykatat kushtetuese evropiane nuk kanë një konsensus të përbashkët për sa i përket juridiksionit të tyre në këtë drejtim. Sjellim në vëmendje jurisprudencën e përdorur nga shumica në lidhje me rastin e Kroacisë, Gjykata Kushtetuese e së cilës i konsideron këto vendime si jashtë juridiksionit kushtetues (*shih Džinić kundër Kroacisë, datë 17.5.2016, §§ 25, 29*). Pavarësisht trajtimit të vendimeve të sekuestrimit në këndvështrim të nenit 1, të protokollit nr. 1, të KEDNJ-së, jo vetëm në këtë vendim, por edhe në praktikën e gjerë të GJEDNJ-së, nuk gjenden raste

në të cilat ajo të ketë konstatuar shkelje nga ana e gjykatave kushtetuese të shteteve anëtare në kuptim të neneve 6 ose 13 të KEDNJ-së apo të ketë përcaktuar detyrimin për zgjerimin e juridiksionit të tyre. GJEDNJ-ja është mjaft e qartë në rastet e konstatimit të cenimit të të drejtave themelore në gjykatën kombëtare më të lartë, kur ka deklaruar cenimin e së drejtës së aksesit të individit dhe mundësinë e rihapjes së procesit si një nga format e përshtatshme për dhënien fund të shkeljes dhe rregullimin e pasojave. Për më tepër, ajo që duhet mbajtur në konsideratë është edhe larmishmëria e sistemeve të ndryshme juridike, të cilat kanë specifikat dhe individualitetin e tyre për sa u përket masave të marra gjatë proceseve penale dhe rrjedhimisht edhe referimi në vendimet e GJEDNJ-së nuk mund të bëhet i shkëputur nga realiteti i secilit shtet anëtar. Për rrjedhojë, argumenti i shumicës se zhvillimi i qasjes së saj edhe në drejtim të vlerësimit të natyrës së vendimeve të ndërmjetme për caktimin e sekuestros bëhet me synim që ankimi kushtetues individual të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen sa më të përshtatshme të të drejtave dhe lirive themelore të individit (*shih paragrafin 26 të vendimit*) nuk qëndron në vlerësimin tonë.

14. Gjithashtu, vlen të përmendim edhe nenin 13 të KEDNJ-së, i cili ka për qëllim ekzistencën e mjeteve juridike efektive në nivel kombëtar për shkeljet e të drejtave të KEDNJ-së përpara vënies në lëvizje të mekanizmit ndërkombëtar të GJEDNJ-së. Në parim, neni 13 përcakton detyrimin e shteteve për të mbrojtur të drejtat substanciale dhe liritë e individit, së pari, brenda sistemeve të brendshme juridike si një garanci shtesë për gëzimin e këtyre të drejtave dhe lirive. Në referim të këtij parashikimi, sistemi gjyqësor shqiptar ka parashikuar shqyrtimin e ankimeve të masave të sekuestrimit në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, të cilat mund të analizojnë në thelb pretendimet e individëve për cenimin e të drejtave të tyre. Për sa kohë neni 13 i Konventës lejon për shtetet një marzh të gjerë vlerësimi në këtë drejtim, detyrimi i shtetit për të mbrojtur të drejtat gjatë procesit gjyqësor të sekuestrimit përmbushet me gjykimin e çështjes deri në Gjykatën e Lartë, gjykim i cili e plotëson këtë standard dhe ofron garanci për mbrojtjen e të drejtave të individit. Në këtë drejtim, Gjykatës nuk i lind asnjë detyrim në nivel ndërkombëtar për të përfshirë në juridiksionin e saj këto vendime, për sa kohë është e mjaftueshme ekzistenca e një mjeti të vetëm efektiv.

15. Në këtë aspekt, i qëndrojmë vlerësimit të Gjykatës ndër vite se vendimet gjyqësore të caktimit të masës së sekuestrimit nuk mund t'i nënshtrohen gjykimit kushtetues për sa kohë ato janë të përkohshme, nuk janë përfundimtare dhe nuk kanë masën e duhur të autonomisë nga procesi përfundimtar. Në këtë aspekt, nuk pajtohemi me shumicën sipas së cilës, me reformën kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016 në juridiksionin e saj u përfshinë edhe të drejtat substanciale, përkundrejt atyre për cenimin e procesit të rregullt ligjor. Ajo vë në dukje se rastet e mëparshme të shqyrtimit të masës së sekuestros, sikurse u theksua më lart, Gjykata i ka vlerësuar në drejtim të elementeve të procesit të rregullt ligjor në aspekt të nenit 42 të Kushtetutës, veçanërisht duke mbajtur parasysh se rasti i parë i përket periudhës para ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. Nga ana tjetër, Gjykata çmon se në praktikën e saj nuk vërehet një qëndrim i konsoliduar për sa u përket këtyre vendimeve" (*shih paragrafin 27 të vendimit*). Në vlerësimin tonë, Gjykata, ndër vite, para dhe pas reformës kushtetuese të vitit 2016, ka analizuar këto lloj vendimesh dhe ka konsoliduar qëndrimin jurisprudencial për to në vendimmarrjet e shqyrtimit paraprak, pasi vendimet e sekuestros lidhen me juridiksionin dhe shterimin, kritere paraprake, përmes të cilave çështjet nuk kalojnë në seancë, por përfundojnë me moskalim në seancë nga kolegjet ose MGJ-ja sipas nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000.

16. Në referim të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, masa e sekuestros preventive vendoset kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera *(pika 1)* dhe mund të hiqet kur ndryshojnë kushtet e zbatimit të saj *(pika 3)*. Kjo masë është një vendim i ndërmjetëm, i domosdoshëm për mbarëvajtjen e procesit penal në kuadër të të cilit krijohen dyshime të arsyeshme për kryerjen e një vepre penale. Ajo nuk përcakton themelin e çështjes dhe, si e tillë, nuk mund të ketë mbrojtje kushtetuese, pasi nuk bën pjesë në kategorinë e rasteve përjashtimore të vendosura deri më tani nga jurisprudenca kushtetuese. Masa e sekuestros synon ndalimin e tjetërsimit ose edhe të përdorimit të

një sendi që lidhet me një vepër penale, me qëllim parandalimin e rëndimit ose të zgjatjes së pasojave të kësaj vepre, ose të kryerjes së veprave të tjera penale për shkak edhe të disponimit të lirë të këtij sendi. Nën këtë analizë, në rastin konkret, nuk identifikohej ndonjë arsye e rëndësishme për të mos iu përmbajtur standardeve të vendosura në lidhje me juridiksionin e Gjykatës për shqyrtimin e vendimeve që caktojnë masën e sekuestros preventive në kuadër të një procesi penal.

17. Për më tepër, përfshirja në juridiksionin kushtetues të këtyre masave mund të kthehet në një mjet joefektiv, ndërsa mund të passjellë mbivendosje të juridiksionit kushtetues me atë të gjyqësorit të zakonshëm. Vlerësimi i përshtatshmërisë së vendosjes së masës së sekuestros preventive dhe i vijimit të zbatimit të saj i përket ekskluzivisht gjykatës së zakonshme, e cila, bazuar në provat dhe rrethanat e rasteve konkrete dhe debatit të zhvilluar ndërmjet palëve, disponon të gjitha mjetet për të krijuar bindjen se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për kryerjen e veprës penale, për lidhjen e sendit që kërkohet sekuestrimi ose të sekuestruar me këtë vepër dhe për mundësinë e rëndimit ose zgjatjes së pasojave të saj nga disponimi i lirë i tij, ose lehtësimin e kryerjes së veprave të tjera penale për shkak të një disponimi të tillë të sendit. Nisur nga fakti se masa e sekuestros është e revokueshme qoftë edhe brenda një kohe të shkurtër, në varësi nga dinamika e procesit, ekziston mundësia e gjendjes përpara situatave kur Gjykata dhe gjykatat e zakonshme do të duhet të bëjnë, në të njëjtën kohë, vlerësime edhe të të njëjtave fakte, por duke arritur në përfundime të ndryshme, çka do të sillte rritjen e pasigurisë juridike. Natyra dinamike e masave të sekuestrimit, përkundrejt gjykimit kushtetues që në parim zhvillohet me ritme më të zgjatura në kohë, potencialisht mund të passjellë zhvillimin e dy gjykimeve paralele për të njëjtin qëllim, pra heqjen e sekuestros, por që mund të kenë rezultate të ndryshme.

18. Duke iu rikthyer rastit konkret, sikurse është pranuar edhe nga vetë kërkuesja, gjatë kohës që çështja kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare në Gjykatë, me vendimin nr. 1985, datë 23.12.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës për revokimin/heqjen e pjesshme të masës së sekuestros preventive të caktuar me vendimin e saj nr. 1529 akti, datë 28.7.2022, për sa u përket disa makinerive dhe pajisjeve. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Një fakt i tillë tregon për pasjen e mjeteve mbrojtëse ndaj masave të sekuestrimit dhe efektivitetin e tyre përpara gjyqësorit të zakonshëm.

19. Në analizë të legjislacionit procedural penal, mundësia e individit për të kërkuar heqjen e masës së sekuestrimit në varësi të kushteve dhe rrethanave konkrete, i garanton atij një mbrojtje kushtetuese në gjykatat e zakonshme, si në drejtim të së drejtës substanciale të pronës, ashtu edhe për sa i përket kohëzgjatjes së procesit, i cili është i ndërvarur nga procesi i themelit për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë. Në këtë drejtim, ligji procedural civil (nenet 399/1 e vijues të KPC-së) ka parashikuar mjete ligjore efektive me qëllim që individit t'i garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për hetimin e veprave penale dhe gjykimin e akuzave penale brenda një afati të arsyeshëm ose edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, një mbrojtje e cila krijon garanci edhe për masat penale të sekuestrimit të pasurisë, të cilat, si rregull, prodhojnë efekte, sipas nenit 275 të KPP-së, deri në zgjidhjen e procesit të themelit, pasi gjykata ose prokurori të shprehet për to.

20. Për sa më lart, vlerësojmë se vendimmarrja për masën e sekuestros preventive nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi i themelit, pjesë e të cilit është dhe konfiskimi i pasurisë, vendimi i të cilit ka aftësinë të ndryshojë dhe të riparojë në masën e duhur efektet që sekuestrimi ka sjellë. Për këtë shkak, Gjykata nuk duhej të ishte larguar nga jurisprudenca e deritanishme në lidhje me përcaktimin e këtyre vendimeve si jopërfundimtare, por duhet të ndalej në fazën paraprake të shqyrtimit të çështjes, pa vijuar më tej me bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkueses.

21. Për sa më lart, jemi të qëndrimit se kërkesa duhej të rrëzohej për këtë shkak.

Anëtarë: Ilir Toska, Elsa Toska

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 24 (Sh) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkueses shoqëria "Kosturr Kromi" sh.p.k. me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve nr. 1529 akti, datë 28.7.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 740, datë 23.8.2022, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2023-413, datë 7.3.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.*", ndaj të njëjtin mendim për rrëzimin e kërkesës, duke u bashkuar me arsyetimin e pasqyruar në mendimin paralel të gjyqtarëve Elsa Toska dhe Ilir Toska, pra që vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare dhe nuk mund t'i nënshtrohen gjykimit kushtetues. Megjithatë, vlerësoj të paraqes një argument shtesë në mbështetje të qëndrimit tim.

2. Po ashtu, i qëndroj të njëjtit vlerësim që ka bërë Gjykata për përfshirjen në juridiksionin kushtetues në raste përjashtimore të vendimeve të ndërmjetme, nëse plotësohen njëherazi tre kushte: i. kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; ii. vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; dhe iii. vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimin nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

3. Në këtë pikë vë në dukje se kriteri i tretë që vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit paraqet një rëndësi të veçantë për përcaktimin e natyrës së vendimit të ndërmjetëm. Duke iu referuar rastit konkret, çmoj se ndonëse shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë. Për rrjedhojë, sikurse u theksua në mendimin paralel, në rastin konkret, nuk konstatohet ndonjë arsye e rëndësishme për ndryshimin e qëndrimit të Gjykatës për sa i përket natyrës përfundimtare të vendimeve të caktimit të sekuestros.

4. Pavarësisht sa më lart, një ndryshim i qasjes do të kishte qenë i justifikuar në rastin kur pasojat e masës së sekuestros do të kishin qenë aq rënduese për një subjekt tregtar, saqë të kombinuara edhe me tejzgjatjen e vazhdimësisë së masës do të sillnin si pasojë riskun e një falimentimi të mundshëm. Megjithatë në rastin konkret duke marrë në konsideratë: i. natyrën e veprës penale të lidhur me mashtrimin, (kryer nëpërmjet shitjes nën kosto të sasisë së kromit, fshehjes së deklarimit të pagimit të një huaje ortakut, shoqërisë kineze dhe kalimit të sasisë së kromit pa faturë shitje); si dhe, ii. faktin që administratori i shoqërisë "Kosturr Kromi" sh.p.k. është larguar nga vendi për t'iu shmangur procesi të hetimit dhe gjykimit, çmoj se ato nuk përbëjnë argument të mjaftueshëm për ndryshimin e qasjes së Gjykatës.

5. Për sa më lart qëndrimi im i referohet çështjes konkrete, ndërsa vlerësimi në të ardhmen do t'i nënshtrohet fakteve rast pas rasti, pasi përcaktimi i natyrës së tyre duhet të bëhet duke u bazuar në rrethanat konkrete, të drejtën substanciale të pretenduar si dhe pasojat konkrete që kanë ardhur nga kjo masë.

6. Në përfundim, vlerësoj se kërkesa duhet të ishte rrëzuar, pasi vendimet e kundërshtuara nga kërkuesja nuk mund të konsideroheshin përfundimtare për gjykimin kushtetues.

Anëtar: Marjana Semini